



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:269202
Datë: 22.03.2021
Numri i dokumentit: 01619318

A.nr. 2267/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me zyrtaren ligjore Besë Sylaj, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, S. K. nga komuna e P..., në Rr..., nr..., të cilin me autorizim e përfaqëson Selatin Ahmeti avokat në Prishtinë, kundër të paditurës, M. P.M. S. – D. A. P. të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 09.03.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, S. K. nga komuna e P...

II. Anulohet aktvendimi i datës 18.05.2017, nr. 03/2019, i të paditurës M. P.M. S. – D. A. P. të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA –së, në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: fletë-kthesa e datës 15.02.2021).

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar në padinë e datës 27.07.2017, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesë padia e tij si e bazuar dhe ti njihet e drejta e pensionit kontribut pagues të moshës si dhe të anulohet vendimi i datës 18.05.2018 i të paditurës si i kundërligjshëm. Thekson se, nga administrimi i provave në seancën e sotme besoj që u vërtetua se paditësi S. K. i plotëson kushtet për fitimin e te drejtës ne pensionin kontribut pagues të moshës sepse i ka plotësuar 15 vite përvojë te punës para luftës. Propozoj që gjykata të merr aktgjykim me te cilin vërtetohet se i njëjti i plotëson kushtet për pensionin e lartpërmendur dhe të aprovohet kërkesë padia e padisë.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 25.06.2020, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar , vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuçi dhe në mënyrë të

drejtë dhe pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me asnjë provë të vetme andaj i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërësi si të pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të datës 09.03.2021 ka administruar provat relevante: vendimi i dt. 18.05.2017; vërtetimi i dt. 02.05.2017 me nr. protokollit 49 nga SHMT "28 Nëntori"; vërtetimi i dt. 16.02.1976 me nr. te protokollit A-198 nga OBPP; dosja e kërkesës me nr. 229967; dokumenti i dt. 18.09.1992; libreza e dt. 01.10.85; vërtetimi i lëshuar nga sekretari I. H. nga SMT 28 Nëntori; vërtetimi i dt. 27.02.2013 me nr. 2377 nga Gjimnazi Sami Frashëri; njoftimi i dt. 17.09.2013; vërtetimi M-4 i dt. 11.10.2016; vendimi i dt. 14.03.2013; vërtetimi M-4 i dt. 20.04.2017; vërtetimi nga Drejtoria Komunale e Arsimit te dt. 25.02.2010; ekstrakti i dt. 31.07.2013; vërtetimi i dt. 01.03.2013 me nr. 46/2013 shkolla e mesme Ismail Qemajli; vërtetimi i dt. 31.10.1980 me nr. protokollit 05.06.-1143; aktvendimi i dt. 08.11.1981 me nr.,422; aktvendimi i dt. 02.09.1980; vërtetimi i dt.27.02.2013 me nr. 243 drejtoria e administratës dhe personelit Prishtinë; vërtetimi i dt. 28.02.2013 me nr. 35-2013 dhe vendimi 15.11.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga provat e administruara gjykata gjen se, me vendimin e organit të shkallës së dytë të datës 18.05.2017, është refuzuar ankesa e paditësit për njohjen e të drejtës në Kategorizim për Pension Kontribut pagues të Moshës, me arsyetimin se nuk janë përmbushur kushtet dhe kriteret e përgjithshme, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara me arsyetimin se nuk janë bashkangjitur të dhëna për 15 vite stazh kontributiv.

Nga vendimet kontestuar del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se *“Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë është konstatuar se nuk janë përmbushur kushtet dhe kriteret e përgjithshme, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara ngase nuk janë bashkangjitur të dhëna për 15 vite stazh kontributiv”*.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referuar dispozitës së nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit NR. 04/L-13 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti me të cilin është përcaktuar që *“Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;1.2. duhet të ketë stazh pensional kontribut dhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999”*.

Ndërsa me Udhëzimin Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues neni 6, paragrafi 2 është përcaktuar që *“ Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në dispozitat e Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, shfrytëzuesit aktual dhe ata që aplikojnë në të ardhmen, duhet të paraqesin dokumentet e nevojshme si: 2.1.Letërnjoftimin e Republikës së Kosovës, 2.2. Ekstraktin e Lindjes dhe 2.3 Të kenë stazh pensional kontribut dhënës së paku pesëmbëdhjetë(15) vjet para datës 01.01.1999, sipas Ligjit të SPI-së të Kosovës, nr.26/83”* i cili duhet të vërtetohet me ndonjë nga këto dokumente si: 2.3.1 vendimin se ka qenë shfrytëzues i pensionit kontribut pagues sipas dispozitave të Ligjit SPI-së Nr. 26/83, para datës 01.01.1999; 2.3.2. çekun për pagesën e pensionit kontributiv sipas dispozitave nga Ligjit SPI-së të Kosovës; 2.3.3. librezën e punës me numrin amëz të të siguruarit; 2.3.4.dëshmin se i ka paguar kontributet vet ose punëdhënësi ku ka punuar”.

Në këtë kuptim gjykata gjen se, paditura ka marr një vendim pa diapozitiv të saktë dhe pa arsyetim, duke cituar si më lartë, duke marrë një vendim i cili nuk përmban elementet kryesore të vendimit të përcaktuar me dispozitat ligjore të cekura më lartë të Procedurës Administrative. Për më tepër e paditura në diapozitivin e vendimit të atakuar nuk ka cekur se ankesa kundër cilit vendim është refuzuar dhe cilin vendim të shkallës së parë e ka lënë në fuqi, po ashtu në vendimin e atakuar nuk ka theksuar mbi cilat prova konkrete e njëjta ka vërtetuar faktin se paditësi nuk ka bashkangjitur të dhëna për 15 vite përvojë pune stazh kontributiv, por vetëm ka dhënë një arsyetim te përgjithshëm pa e vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike.

Gjykata si rregull në konfliktin administrativ vendos në bazë të fakteve të gjendjes faktike të vërtetuara nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1245/17 data: 09.03.2021

Zyrtare ligjore
Besë Sylaj

Gjyqtare
Luljeta Maxhuni

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:269202
Datë: 22.03.2021
Numri i dokumentit: 01619318